



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 48**

**Datë: 10.11.2020. Ora: 13:00**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Valdete Daka, kryetare e KQZ-së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Artan Asllani, Nend Rikallo, Rifat Krasniq.**

**SKQZ: Burmi Ahmetaj, kryeshef.**

**ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.**

**Përkthyes: Argjina Misini**

**Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

**RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.46/2020.

**2. Aktivitetet e SKQZ-së**

**3. Aktivitetet e ZRPPC-së**

- Shqyrtim dhe miratimi i Udhëzuesit për hedhjen e shortit dhe renditjen në fletëvotim të subjekteve politike për zgjedhjet jashtëzakonshëm për Kryetar Komune në Mitrovicën e Veriut;
- Shqyrtim dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut;

**4. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

- **Këshilli për Çështje Ligjore;**

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Gjakovë.

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzimit për Regjistrim dhe Votim të Votuesve të cilëve për shkak të infektimit me COVID-19 janë në izolim dhe votuesve të cilëve iu është caktuar masa e vetëizolimit,

- Përbërja e KVV-e për zgjedhjet për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut

## 5. Të ndryshme.

---

### 1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

**Valdete Daka:** E hapi mbledhjen e 48-të, a ka dikush vërejtje në rendin e ditës, nëse jo, kush është për...? Anëtarët e KQZ -së, në vazhdim miratuan rendin e ditës. Pastaj, anëtarët e KQZ-së miratuan edhe procesverbalin nga mbledhja nr.46/2020 e KQZ.

Po ashtu, në kuadër të aktiviteteve të SKQZ-së, anëtarët e KQZ-së dëgjuan raportin e aktiviteteve në mes të dy mbledhjeve të krejshefit, **Burim Ahmetaj**. Raporti, i cili, paraprakisht u është dërguar me shkrim anëtarëve të KQZ-së, kishte të bënte me specifikat, me rrjedhën e përgatitjeve, s'i dhe me organizimin intensiv të procesit të zgjedhjeve të jashtëzakonshme në komunën e Podujevës dhe të Mitrovicës veriore: periudha për aplikim e votuesve jashtë Kosovë e cila, ka përfunduar më 7 nëntor; Kanë aplikuar 450 aplikues përmes imellit: 427 janë aprovuar, 27 janë refuzuar; sipas komunave ku mbahen zgjedhjet, 447 janë nga komuna e Podujevës dhe 3 votues janë nga komuna e Mitrovicës;

Sekretariati i ka njoftuar aplikuesit për dokumentet shtesë që duhet t'i kenë votuesit; Periudha e ndërrimit të QV është në vazhdim e sipër; Periudha e për regjistrimin e votuesve me nevoja të veçanta ka përfunduar: kanë aplikuar 88 persona në Podujevë, dhe 6 nga Mitrovica. Këtu ka edhe persona me covid – 19. Për këta persona, kemi të përgatitur specifikat administrative dhe ekipet mobile se s'i do të votojnë këta pesona; Janë përgatitur dizajnet e formave zgjedhore; Në Sekretariat kemi bërë edhe regjistrimin e pasurisë jofinanciare, dhe kemi formuar komisionin për vlerësimin e kësaj pasurive...

**Alim Rama:** Po pyes, a e ka nënshkruar Burimi aktvendimin, nëse jo, ky është i jashtëligjshëm...! Ai, bëri vërejtje rreth formimit – aprovimit javën e kaluar të KKZ-ve në Mitrovicë. Mori shembull një rast, një anëtare të KKZ-së që ka qenë pjesë e këtij procesi në 2013, 2014, 2017...s'i anëtare e PDK-së...Arsyetimi ka qenë përvoja, por është nominuar si e pavarur, por nuk është e pavarur...! Tash, kemi ardhur në pozitë që PDK ka dy anëtarë në Mitrovicë të veriut... Këtu, unë shoh tendenca të manipulimit dhe, jo transparencë...

Në këtë pikë, diskutoi për rrjedhën e procesit edhe Sami Kurteshi, Valdete Daka, Burim Ahmetaj. (nuk dëgjohej diskutimi – teknikisht),

**Arianit Elshani:** Një narrativë, një diskurs ka filluar që muaj, ndoshta jo kundër subjektit që unë e përfaqësoj PDK –në, por kundër KQZ-së. Një kredibilitet që është arritur për 10 vite për mbarëvajtjen dhe transparencën sa më të mirë, për hir të korrektësisë dhe opinionit publik, por edhe për VV-në, pësonin në fjalë nuk e njoh por për më tepër, është hera e parë që VV merr pjesë në zgjedhjet komunale në Mitrovicën e veriut... Ajo, ndoshta ka qenë votuese e tjetërkujt, prandaj nuk është çështje që duhet të personalizohet!

Po ashtu, tha z. Elshani, edhe vetë Sekretariati është përcaktuar që, njerëzit me përvojë të jenë në proces, madje edhe për faktin se ne për herë të parë organizojmë zgjedhje në mënyrë të pavarur s'i KQZ...

**Alim Rama:** Tendenca, është e qartë. I kemi dokumentet: një anëtarë dikur ka qenë s'i KKZ s'i pjesë partiake, dhe tash s'i të pavarur...

**Valdete Daka:** Është ngritë një çështje. Anëtari, ka sjellë edhe dokumentacion. Le ta shqyrton Sekretariati edhe njëherë, dhe ne kemi mundësi të ndërmarim hapa të mëtejme...

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Burim Ahmetaj në cilësinë e krye shefit, dhe Valdete Daka.

## **2. Aktivitetet e ZRPPC-së**

Shqyrtim dhe miratimi i Udhëzuesit për hedhjen e shortit dhe renditjen në fletëvotim të subjekteve politike për zgjedhjet jashtëzakonshëm për Kryetar Komune në Mitrovicën e Veriut;

**Yll Buleshkaj:** Ne kemi vazhduar punën, dhe pas certifikimit të kandidatëve, më 12 nëntor e kemi caktuar datën për tërheqjen e shortit dhe vendosjen e kandidatëve në fletëvotim. E kemi materialin, dhe tashmë, ne kemi kryer edhe çështjet administrative.

Ftesat, tha z. Buleshkaj, i kemi dërguar për subjektet politike, dhe tërheqja e shortit mendojmë të bëhet ën selinë e KQZ.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë udhëzues.

Shqyrtim dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut;

**Yll Buleshkaj:** Sipas planit, ne kemi kontaktuar entitetet që kanë akredituar vëzhguesit për ta konfirmuar numrin në komunën e Podujevës, s'i dhe nëse ka ende vëzhgues të mundshëm për tu akredituar. Po, kanë konkuruar edhe 2 OJQ, dhe 3 media. Gjithsej, bëhet fjalë për kreditimin e 24 vëzhgues që duhet të miratohen.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e ZRPP për akreditimin edhe të 24 vëzhguesve të rinjë.

**Valdete Daka:** Ndoshta, do të kemi nevojë që të marrin një vendim për numrin e vëzhguesve të lejuar nëpër VV, duke i respektuar edhe vendimet e institucioneve të tjera për shkak të Covid, mirëpo të shohim në mbledhje tjetër se s'i do të rregullohet kjo...

**Burim Ahmetaj:** Ne, jemi duke e përgatitur udhëzimin administrativ që do të reflektoj edhe numrin e lejuar në VV-me...

### 3.Raporti i Këshillave të KQZ-së

#### 1.Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Gjakovë:

**Arianit Elshani:** Këshilli, ka shqyrtuar kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Gjakovë, dhe se këshilli mbasi që ka trajtuar ligjshmërinë e kësaj kërkesë ka vendosur që ta rekomandojë këtë zëvendësim, meqë i plotëson kushtet.

**Valdete Daka:** E kemi rekomandimin, pra kush është për që z. Demë Avdijaj, të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Gjakovë nga subjekti politik Nisma për Kosovën, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm Fazli Hoxha.

#### 2.Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzimit për Regjistrim dhe Votim të Votuesve të cilëve për shkak të infektimit me COVID-19 janë në izolim dhe votuesve të cilëve iu është caktuar masa e vetë izolimit:

**Alim Rama:** Këshilli, ka bërë shqyrtimin e udhëzimit për regjistrimin për votim të votuesve të cilët, për shkak të infektimit me COVID-19 janë në izolim dhe, të votuesve të cilëve iu është caktuar masa e vetë izolimit. Udhëzimi, është bërë në bazë të masave të IKSHP-së. Udhëzimi si i tillë, është miratuar unanimitisht në këshill, por ne mund të diskutojmë më tej në bazë të një takimi të bordit Këshillëdhënës për Covid – 19, dhe një dokument që kemi pranuar nga Ministria e Shëndetësisë...

Në vazhdim, z. Alimi, shpjegoi specifikat e udhëzimit administrativ, masat e përcaktuara, rregullat e votimit në ditën e zgjedhjeve, formimin e ekipeve mobile, mjetet mbrojtës, distancat etj.

Në këtë pikë, diskutuan edhe Eshref Vishi, i cili dha vlerësime, por edhe shtroi pyetje rreth specifikave të udhëzimit... Në detaje, shpjegime dha kryeshefi z. Ahmetaj, gjithashtu edhe kryetarja Valdete Daka, Alim Rama, Arianit Elshani, Arianit Elshani.

Në fund, kryetarja Daka, kërkoi që sa më urgjent udhëzimi të jetë gati, madje edhe në përkthim sepse duhet të shpërndahet...Po ashtu, edhe zëdhënësi ta sqarojë me mediat sa më shumë këtë udhëzim, se s'i votohet...

Anëtarët e KQZ-së, mbas një elaborimi substancial të udhëzimit, e miratuan me një votë abstenimi.

#### Përbërja e KVV-e për zgjedhjet për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut

**Alim Rama:** Këshilli, ka marrë vendim për rekomandim edhe pse unë, kam pasur rezervat e mia. Për shkak të covidit, Sekretariati ka propozuar që numri i anëtarëve në vendvotim të zbritet në 5, e unë e kam kundërshtue. Në Podujevë, i kemi 6 anëtarë. Pra, covidit ndikon si atje, s'i në Mitrovicë...

**Sami Hamiti:** E kemi diskutuar, por ne nuk e kemi zvogëluar sepse ligji e përcakton 5 ! Specifikat janë ndryshe sepse në Podujevë janë vetëm 3 subjekte, kurse në Mitrovicë janë 4. Në parim, ligji e parasheh kështu...

**Nenad Rikallo:** Unë do të votoj kundër, sepse do të jetë vështirë organizimi i zgjedhjeve me 5 anëtarë...

Në fund, me 7 vota për, 2 abstenime dhe 1 votë kundër, u miratua Përbërja e KVV-e për zgjedhjet për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut.

#### **4.Të ndryshme !**

**Alim Rama:** Ndoshta, duhet t'i diskutojmë masat e institutit, dhe raportin që sot e kemi pranuar...

**Valdete Daka:** Jo, s'kemi si ta diskutojmë. Raporti, më është dhënë mua, por letrën zyrtare e keni të gjithë. Kështu që këtë çështje, mund ta diskutojmë në një takim...